

ANALIZA

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË INSTITUCIONEVE QENDRORE PËR 2019

Në datën 28 janar 2020 u zhvillua analiza vjetore e Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore (DAIQ). Kjo analizë u hartua nën dritën e njohjes dhe vetëvlerësimit të Kornizës së Matjes së Performancës me qëllim evidentimin e fuqive, dobësive, shanseve dhe kërcënimeve që prekin punën audituese brenda Departamentit. Korniza e Matjes së Performancës konsiderohet si një mjet i rëndësishëm për menaxhimin, matjen, identifikimin dhe raportimin e performancës së aktivitetit të vetë, me qëllim përmirësimet e mëtejshme, për arritjen e objektivave e synuara, si më poshtë vijon:



Sipas programit vjetor të vitit 2019 të miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.256, datë 31.12.2018, i ndryshuar, Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore i janë planifikuar **26** subjekte për të audituar të cilat i ka përfunduar të **26-ta duke realizuar kështu 100%** planin e auditimeve të këtij viti. Konkretisht ka realizuar: **7** auditime përputhshmërie (nga këto 3 auditime tematike); **2** auditime financiare; **16** auditime të përziera financiare/përputhshmërie; 1 auditim për verifikimin e zbatimit të rekomandime të lëna gjatë vitit 2018.

Bazuar në metodologjinë e riskut dhe materialitetit, me këto 26 auditime janë audituar fonde buxhetore në vlerën totale rreth 95 miliard lekë, kryesisht: për “Pagat e personelit” zënë rreth 22% ose 20 miliard lekë; për “Mallra dhe shërbime të tjera” zënë rreth 18% ose 17 miliard lekë; për “investime” zënë rreth 25% ose 24 miliard lekë të totalit; të ardhurat buxhetore në masën 35% ose 33 miliard lekë.

Në zbatim të standardeve të auditimit financiar dhe të përputhshmërisë “ISSAI 1700 dhe ISSAI 4000”, janë audituar pasqyrat financiare dhe përputhshmëria e përdorimit të fondeve publike. dhe në përfundim të auditimeve kemi dalë dhe janë dhënë këto opinione:

-Në 18 subjekte kemi dalë me opinione për pasqyrat financiare. Ndër problematikat e konstatuara nga auditimi i pasqyrave financiare përmendim ato që lidhen: me mos konsolidimin e pasqyrave financiare pas ndryshimit të fushës së përgjegjësive të ministrive, moskryerjen e inventarizimit periodik dhe mos-rakordimit të vlerës fizike me atë kontabël,

mungesat e vazhdueshme në relacionet shpjegues të zërave materiale në kundërshtim me kërkesat e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit; mos zbatimin e parimit të kontabilitetit rrjedhës; mos llogaritja e saktë e amortizimit; etj. ***Nisur nga këto problematika kemi dhënë: 8 opinione të pakualifikuara, 6 opinione të kualifikuara, 1 opinion kundërshtues dhe 1 refuzim opinionit.***

-Në 20 subjekte kemi dhënë opinion përputhshmërie. Ndër problematika të konstatuara përgjatë auditimeve të përputhshmërisë përmendim: parregullsi dhe shkelje ligjore të shumta gjatë zbatimit të rregullave të prokurimit dhe të koncesioneve publike; moszbatim i saktë i metodologjisë në përcaktimin e kostos së zërave buxhetorë; thyerje materiale të sistemeve të kontrollit përgjatë procesit të inventarizimit dhe transferimit të pasurisë shtetërore; mosrealizim të fondeve dhe projekteve të parashikuara në buxhet; thyerje të kontrolleve përgjatë procesit të krijimit të të ardhurave dytësore, thyerje të sistemeve të kontrollit që lidhen me procedurat e rekrutimit të punonjësve; mungesa të akteve administrative për kontabilizimin e penaliteteve; mungesë saktësie në kërkesat buxhetore të PBA-ve; etj. ***Nisur nga këto problematika kemi dhënë: 8 opinione të pakualifikuara, 11 opinione të kualifikuara, dhe 1 opinion kundërshtues.***



Po kështu, si pasojë e parregullsive dhe shkeljeve ligjore të konstatuara, për përmirësimin e performances së subjekteve të audituara kemi lënë gjithsej **351** rekomandime për zbatim si: **25** për përmirësimin e akteve ligjore dhe nënligjore; **300** për përmirësimin e veprimtarisë së institucioneve me karakter organizativ; **26** për shpërblim dëmi ekonomik në shumën totale rreth **18,785,877 mijë lekë**, dëm ekonomik potencial në shumën **10,980,000 mijë lekë**, dhe për menaxhim jo efektiv fondesh buxhetore në shumën totale **3,088,199 mijë lekë**; për punonjësit e bërë përgjegjës për këto shkelje janë kërkuar **76** masa disiplinore dhe **7** masa administrative.

Pesha më e madhe dhe me të konsiderueshme e shkeljeve dhe parregullsitë që janë reflektuar, me dëm ekonomik, me dëm ekonomik potencial për buxhetit të shtetit apo edhe me menaxhim jo efektiv është konstatuar: në auditimin e Autoritetit Rrugor Shqiptar është konstatuar dëm ekonomik në vlerën totale 662,914 mijë lekë dhe menaxhim jo efektiv të fondeve në vlerën totale lekë 488,121 mijë lekë; në auditimin e Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizime është konstatuar dëmi ekonomik në vlerën totale 495,463 mijë lekë, dëm ekonomik potencial në vlerën 11,100,000 mijë lekë dhe menaxhim jo efektiv të fondeve në vlerën totale 529,912 lekë; në auditimin tematik në Avokaturën e Shtetit është konstatuar: dëm ekonomik potencial

buxhetit të në vlerën 110,000,000 euro; në auditimin e Fondin Shqiptar të Zhvillimit është konstatuar menaxhim jo efektiv të fondeve në vlerën totale 522, 000 mijë lekë.

Një indikator i rëndësishëm për matjen e Performancës të punës së Departamentit është edhe zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme. Kështu, në muajin qershor-korrik 2019, Departamenti përfundoi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e kryera gjatë vitit 2018. Në auditimet e kësaj periudhe janë rekomanduar gjithsej **454** masa, nga të cilat janë pranuar nga subjektet **436** dhe **18** të tjerat nuk janë pranuar. Në këtë auditim konstatuam se, nga **436** masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht **212** ose **49%** e tyre; janë zbatuar pjesërisht **5** masa, ose **1%** e totalit të masave të pranuar; ishin në proces zbatimi **168** masa ose **39% e totalit**. Kanë mbetur pa zbatuar **51** masa, ose **12%** e totalit të masave të pranuar.

Objektivat e Departamentit për të vitin 2020:

- 1.** Ruajtja e akordit të numrit të auditimeve të kryera gjatë 5 vjeçarit të fundit, me tendence rritjen e numrit të auditimeve financiar dhe të përputhshmërisë;
- 2.** Përmirësimin e proceseve që lidhen me përdorimin dhe vënien në eficence të plotë të Rev-Zonës nga audituesit e Departamentit;
- 3.** Përmirësimin e proceseve që lidhen me planifikimin e auditimit deri në përgatitjen e Programit të Auditimit, si një dokument i rëndësishëm, që dikton edhe suksesin ose jo të auditimit. Identifikimi i risqeve, merr rëndësi të veçantë në këtë fazë të auditimit. Të gjithë audituesit duhet të angazhohen në njohjen e standardeve, Manualeve të KLSH-së si dhe Rregullores së Procedurave të auditimit, jo vetëm për të plotësuar dhe ndjekur me kujdes gjithë dokumentet standarde, por gjithashtu për t'i zhvilluar e plotësuar më tej ato. Ky objektiv do të arrihet nëpërmjet trajnimeve të shumta që do të organizohet nga vetë Departamenti, por edhe nga institucione brenda vendit dhe jashtë vendit.
- 4.** Në frymën e porosisë së Kryetarit dhe të standardeve të auditimit për transparencën ("ISAI 12"), do të rrisim praninë e audituesve të departamentit në shtypin e shkruar dhe atë elektronik.
- 5.** Në frymën e mesazhit të Kryetarit, çdo auditues do të zbërthejë Strategjinë e Zhvillimit të KLSH për vitet 2018-2020, veçanërisht në lidhje me forcimin e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, rritjen e nivelit të rekomandimeve të pranuar dhe të zbatuara, pasi efekti real i aktivitetit auditues së Departamentit matet me nivelin e zbatimit të rekomandimeve nga subjektet publike të audituara.
- 6.** Do të rrisim kontrollin cilësisë së auditimeve, si një hallkë kjo e kontroleve të brendshme të vetë Departamentit. Planifikimi i saktë i kohës për secilin auditues, si dhe objektivat specifike dhe të qarta për secilin prej funksioneve brenda Departamentit do të jetë një element kyç që do të mbahet në vëmendje gjatë çdo projekti auditimi, me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë individuale dhe si pasojë rritjen e cilësisë së auditimeve.